



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1939/1 prot.,

Datë: 21.07.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SAHORA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-46112-04-25-2025, me objekt “Blerje pompash rezerve për stacionet e pompimit të Rajonit”, me fond limit 32,928,219 (tridhjetë e dy milion e nëntëqind e njëzetë e tetë mijë e dyqind e nëntëmbdhjetë) lekë **pa TVSH**. Vlera e fondit Limit në monedhen nderkombetare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë është 332,776.34 (Treqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pike tridhjetë e katër) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 02-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Sahora” SHPK me NIPT L91703022T dhe adresë Rruga “Komuna e Parisit”, Hyrja 2, apartamente 30, ap me nr. Pasurie 6/758+2-30, vol nr. 59, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A
Qafë-Gjashtë, Sarandë, Rruga “Skënderbeu”

Në datën 18.07.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1939/2025 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5577 e operatorit ekonomik “Sahora” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-46112-04-25-2025, me objekt “Blerje pompash rezerve për stacionet e pompimit të Rajonit”, me fond limit 32,928,219 (tridhjetë e dy milion e nëntëqind e

njëzetë e tetë mijë e dyqind e nëntëmbdhjetë) lekë **pa TVSH**. Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 332,776.34 (Treqind e tridhjetë e dy mije e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pike tridhjetë e kater) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 02-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Sarandë SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “SAHORA” SHPK.

Bazuar në gjurmën “b”, të pikës 4, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “SAHORA” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1939/2025 prot., datë 21.07.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5577, datë 18.07.2025.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

2.8. Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tabele, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës. Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr Emertimi i produkteve Emertimi kompanise prodhuese, adresa, ëeb-siti Emertimi i katalogut Referenca ne katalogje/ Shënimet

KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog

Emërtimi I produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

-Emri, Adresa dhe ëeb-site i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

-Referenca në katalogje, kodi i produktit të plotësohet (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr,i faqes)duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku AK mund të gjejë specifikimet teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

Operatori ekonomik “SAHORA” shpk me NIPT L91703022T nuk ploteson specifikimet teknike per pompat me nr: 3,4,5,7,8,17,18.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 21.07.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro